

Plani për Përmirësimin e Integritetit të Administratës Tatimore të Kosovës

Dokumenti për Indikatorë

2021 – 2023

Përmbajtja

Hyrje	3
1. Rritja e efikasitetit.....	4
2. Pjesëmarrja e përmbushjes vullnetare tek të hyrat totale tatimore	4
3. Numri mesatar i ditëve për rimbursim të tatimeve.....	5
4. Numri i kontrollave që përfundojnë në ankimim.....	6
5. Pjesëmarrja e ankesave që rezultojnë me vendim në favor të tatimpaguesit në totalin e ankesave	7
6. Numri i rasteve të mbyllura në mbledhjen e detyrueshme si përqindje e rasteve totale aktive në mbledhjen e detyrueshme	7
7. Volumi i borxhit të inkasuar si përqindje e shtimit të stokut të borxhit.....	8
8. Rritja e numrit të vizitave të bazuara në vlerësim të rrezikut	9
9. Rritja e kontrolleve bazuar në vlerësim të rrezikut.....	9
10. Caktimi i zyrtarëve tatimor për kontroll bazuar në vlerësim të rrezikut.....	10
11. Trajtimi i kërkesave specifike të tatimpaguesve bazuar në vlerësim të rrezikut	10
12. Numri i sistemeve të jashtme të ndërlidhura me sistemin e ATK-së.....	11
13. Përmirësimi i aftësive të zyrtarëve me notë të ulët.....	12
14. Ngritja e aftësive të zyrtarëve të ATK-së	12
15. Publikimi i të dhënave të hapura	13
16. Rritja e kapaciteteve të zyrtarëve që komunikojnë me qytetarët/tatimpaguesit	14

Hyrje

Indikatorët në këtë dokument shërbejnë për matjen e implementimit të Planit për Përmirësimin e Integritetit, por ky është një dokument i hapur të cilin ATK mund ta ndryshojë duke shtuar indikatorë sipas nevojës gjatë periudhës të zbatimit. Varësisht nga afati që i caktohet këtij dokumenti, ATK mbetet të bëjë përcaktimin, zbatimin, e monitorimin duke bërë:

- Mbledhjen e të dhënave për të mundësuar matjen e niveleve referuese dhe caqeve
- Caktimin e niveleve referuese (baselines)
- Monitorimin e periudhës raportuese për secilin indikator (muajore, tremujore, apo vjetore)
- Monitorimin e caqeve që do të arrihen për çdo muaj/tremujor/vit për secilin indikator

Indikatorët e përdorur në këtë dokument janë bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare¹ të cilat janë relevante dhe të matshme për ATK-në. Këto burime përfshijnë Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, etj., me fokus në hulumtimet dhe metodologjitë e përdorura prej tyre në matjen e performancës së institucioneve publike, e në veçanti të administratave tatimore.

Në thelb të përzgjedhjes së këtyre indikatorëve është nxjerrja e të dhënave mbi përmbushjen e aktiviteteve të caktuara të ATK-së, përcjellja e rregullt e tyre, e krahasimi me periudhat e kaluara për të matur se në ç'masë janë arritur qëllimet e institucionit. Nxjerrja e të dhënave numerike për të matur performancën lehtëson punën e institucionit në priorizimin e resurseve dhe planifikimit më të mirë. Gjithashtu, shërben si një bazë objektive rreth të cilës mund të fokusohet dialogu me partnerët e jashtëm (sektori privat, OJQ-të, donatorët, etj.) mbi arritjet dhe hapësirat për përmirësim.

¹ Tax Administrations and Small and Medium Enterprises (SMEs) in Developing Countries - World Bank Group
< <http://documents.worldbank.org/curated/en/711511468779448847/pdf/391100Taxadmin01PUBLIC1.pdf>>
Tax Administration in OECD and Selected Non-OECD Countries: Comparative Information Series
< <https://www.oecd.org/tax/forum-on-tax-administration/publications-and-products/comparative/CIS-2010.pdf>>
Revenue Administration: Performance Measurement in Tax Administration – IMF
< <https://www.imf.org/external/pubs/ft/tnm/2010/tnm1011.pdf>>

I. Rritja e efikasitetit

$$Kosto e mbledhjes (efikasiteti) = \frac{Buxheti\ i\ ATK_t}{T\ e\ hyrat\ nga\ ATK_t} \times 100$$

Ky indikator mat efikasitetin e institucionit nga këndvështrimi i shpenzimeve të nevojshme për mbledhjen e një sasive të caktuar të hyrash, pra vlerëson se sa është kosto e mbledhjes së tatimit në vend. Bie fjala, ky indikator synon të masë sa janë shpenzimet buxhetore të institucionit për mbledhjen e 100 eurove të hyra tatimore. Sa më i ulët të jetë ky indikator, është sinjal i një menaxhimi më efikas të mbledhjes së tatimeve.

	2017	2018	2019
Buxheti i ATK	8,807,447	9,271,843	11,069,478
Të hyrat e arkëtuara nga ATK	414,355,294	456,798,495	504,281,866
Kosto e mbledhjes	2.13%	2.03%	2.19%

Burimi: Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe Raporti Vjetor i ATK

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Menaxhmenti i ATK-së

Periudha raportuese: Vjetore

Niveli Referues: [2.11%]

Caqet: [2021: 2.11%; 2022: 2.05%; 2023: 2.0%]

Kontribuon tek: Shtylla I

Risqet e implementimit: Ngjarje të pa parashikuara në ekonomi, rimëkëmbje më e ngadaltë pas pandemisë, ndryshime legjislative dhe proceduriale brenda institucionit

2. Pjesëmarrja e përmbushjes vullnetare tek të hyrat totale tatimore

$$Përmbushja\ vullnetare = \frac{Tatimi\ i\ mbledhur\ nga\ përmbushja\ vullnetare_t}{T\ e\ hyrat\ nga\ ATK_t} \times 100$$

Ky indikator mat se sa nga të hyrat që mbledh ATK vijnë nga përmbushja vullnetare; pra, shumën e tatimit të mbledhur sipas deklaratave tatimore të dorëzuara nga tatimpaguesit tek ATK. Pra, këtu nuk përfshihen të hyrat që rezultojnë nga kontrollet, gjrobat, ndëshkimet, interesi, mbledhja e detyrueshme, etj. Këto të fundit janë instrumente kyçe të ATK dhe duhet të forcohen, por ky indikator tregon se sa nga të hyrat që ATK arkëton mbledhen pa pasur nevojë që të shfrytëzohen instrumentet e detyrimit. Ngritja e nivelit të këtij indikator do të pasqyrojë ngritjen e nivelit të edukimit të tatimpaguesve në përmbushjen vullnetare të obligimeve tatimore, gjë që do të zvogëlojë nevojën e përdorimit të instrumenteve detyruese për arkëtim të të hyrave tatimore.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Përgjegjësia primare:
Departamenti për Plan dhe Raportim, Përgjegjësia sekondare: TI

Periudha raportuese: Vjetore

Niveli Referues: [88.5%]

	2018	2019	2020
Tatimi i mbledhur nga përmbushja vullnetare	399,698,683	445,280,888	419,401,770
Të hyrat nga ATK	456,798,495	504,281,866	467,039,833
Përmbushja vullnetare	87.5%	88.3%	89.8%

Caqet:² [2021: 91.5%; 2022: 93.0%; 2023: 95.0%]

Kontribuon tek: Shtylla I

Risqet e implementimit: Faktorë të jashtëm, ndryshime legjislative dhe proceduriale brenda institucionit

3. Numri mesatar i ditëve për rimbursim të tatimeve

Koha mesatare e rimbursimit të tatimit

Ky indikator ka të bëjë me funksionin e rimbursimeve tatimore, më saktësisht mat kohën mesatare për rimbursimin e bilancit kreditor të tatimit tek tatimpaguesit, në ditë. Ky indikator veçse ekziston në raportet e ATK-së. E njëjta formulë aplikohet për të tri tatimet (TAK, TAP dhe TVSH).

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Departamenti i Rimbursimeve
Periudha raportuese: Mujore

Niveli Referues: [22.2]

	2018	2019	2020
TVSh (në ditë)	21.7	18.7	23.0
TAK (në ditë)	21.7	25.9	26.6
TAP (në ditë)	32.1	19.1	16.1
Mesatarja (TVSH, TAK, TAP)	27.6	19.1	20.0

Caqet: [2021: 20 ditë; 2022: 19 ditë; 2023: 18 ditë]

Kontribuon tek: Shtylla I dhe Shtylla II

² Caqet për indikatorin 2 janë bazuar tek Strategjia e ATK 2021-2025, specifikisht tek TKP 7

Risqet e implementimit: Faktorë të jashtëm, mungesa e stafit, mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional, vonesa e konfirmimit të gjendjes së tatimpaguesit me mbledhjen e detyrueshme.

4. Numri i kontrollave që përfundojnë në ankimim

$$\text{Kontrollat në ankimim} = \frac{\text{Numri i ankesave për rezultate të kontrollit}_t}{\text{Numri total i kontrolleve}_t}$$

Ky indikator synon të mat se sa nga rezultatet e kontrollit përfundojnë në procedurë ankimore, për t'u trajtuar më tej. Pra, si indikator nuk ka për qëllim të masë kualitetin e kontrolleve apo procedurës ankimuese, por vetëm tenton të sqarojë se sa nga rastet e kontrolleve shkaktojnë mosmarrëveshje mes tatimpaguesit dhe ATK-së. Sipas nevojës, i njëjti mund të aplikohet edhe për vizitat përmbushëse.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Departamenti i Kontrollit

Periudha raportuese: Tremujore

Niveli Referues: [17.9%]

	2018	2019	2020
Numri total i kontrolleve	1,714	1,915	1,014
Numri i ankesave për rezultate të kontrollit	298	346	188
Kontrollat ne ankimim	17.3 %	18.1%	18.5%

Caqet: [2021: 18.0%, 2022: 17.0%, 2023: 16.0%]

Kontribuon tek: Shtylla I

Risqet e implementimit: Ndryshimet legislative dhe ndryshime proceduriale të brendshme të institucionit.

5. Pjesëmarrja e ankesave që rezultojnë me vendim në favor të tatimpaguesit në totalin e ankesave

$$\text{Efektiviteti i ankimit} = \frac{\text{Numri total i ankesave që rezultojnë në favor të tatimpaguesit}_{t_3}}{\text{Numri total i ankesave}_t}$$

Ky indikator mat normën e ‘suksesit’ të procedurës ankimore, pra se sa nga ankesat totale lidhur me rezultatet e kontroleve përfundojnë në favor të tatimpaguesit.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Divizioni i Ankesave

Periudha raportuese: Vjetore

Niveli Referues: [25.7%]

	2018	2019	2020
Ankesat në favor të tatimpaguesve	166	138	134
Total ankesat	602	612	496
Efektiviteti i ankimit	27.6%	22.5%	27.0%

Caqet: [2021: 28%, 2022: 29%, 2023: 30%]

Kontribuon tek: Shtylla I

Risqet e implementimit: Ndryshimi i qasjes së deritanishme lidhur me procedurën e ankesave, mungesë e stafit për vlerësim të ankesave.

6. Numri i rasteve të mbyllura në mbledhjen e detyrueshme si përqindje e rasteve totale aktive në mbledhjen e detyrueshme

$$\text{Efikasiteti i mbledhjes së detyrueshme} = \frac{\text{Rastet e mbyllura}_t}{\text{Totali i rasteve për mbledhje}_t}$$

Ky indikator synon të masë se sa nga rastet për mbledhje të detyrueshme trajtohen në raport me totalin, pra sa është norma e efikasitetit të menaxhimit të rasteve të mbledhjes. Në kombinim me të dhënat për stokun e borxhit, ky indikator jep informacion mbi atë se a menaxhohet në mënyrë efikase mbledhja e detyrueshme, apo krijimi i borxhit tatimor në ekonominë e Kosovës është shumë i shpejtë.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Departamenti i Mbledhjes së Detyrueshme

³ Ankesat përfshijnë: kontrollet, përcaktimet zyrtare, ndëshkimet dhe të tjera. Në këtë indikator përfshihen të gjitha ankesat që kanë të bëjnë me pakënaqësitë e tatimpaguesit.

Periudha raportuese: Tremujore

Niveli Referues: [27.3%]

	2018	2019	2020
Rastet e mbyllura në vitin ⁴	858	2,009	809
Totali i rasteve për mbledhje	3,603	6,450	3,004
Efikasiteti i mbledhjes së detyrueshme	23.8%	31.1%	26.9%

Caqet: [2021: 27.5%, 2022: 28.0%, 2023: 28.5%]

Kontribuon tek: Shtylla I

Risqet e implementimit: Mungesë e stafit, faktorë të jashtëzakonshëm, rastet e trashëguara në departamentin e mbledhjes së detyrueshme, vendime potenciale të qeverisë për falje/shtyerje të pagesave.

7. Volumi i borxhit të inkasuar si përqindje e stokut të borxhit

$$\text{Efikasiteti në uljen e borxhit} = \frac{\text{Borxhi i inkasuar}_t}{\text{Stoku i borxhit}_t}$$

Ky indikator synon të krahasojë se si qëndron inkasimi i borxhit në krahasim me shtimin (natyror) e stokut të borxhit, pra krahason përpjekjet e ATK-së për të ulur stokun e borxhit me krijimin natyral të borxhit tatimor në ekonomi.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Departamenti i borxhit

Periudha raportuese: Tremujore

Niveli Referues: [24.2%]

	2018	2019	2020
Borxhi i inkasuar	75,332,172	103,444,066	97,563,764
Stoku i borxhit	367,008,982	357,294,252	418,880,661
Efikasiteti në uljen e borxhit	20.5%	28.9%	23.2%

Caqet: [2021: 25.0%, 2022: 27.0%, 2023: 29.0%]

Kontribuon tek: Shtylla I

Risqet e implementimit: Mungesë e stafit dhe faktorë të jashtëzakonshëm

⁴ Rastet e mbyllura përfshijnë tatimpaguesit që kanë paguar borxhin si rezultat i mekanizmave të mbledhjes së detyrueshme dhe krijimi i marreveshjeve ATK-tatimpagues. Ketu nuk përfshihen rastet kur borxhi vjetërohet (me shume se 6 vite).

Në vijim kemi disa indikator të ndryshëm, por që nga aspekti operacional synojnë të matin se sa arrin ATK të shndërrojë funksionet e veta në funksione të bazuara në rrezik. Pra, operacionet kryhen varësisht nga ajo se çfarë diktojnë sistemet e automatizuara, duke larguar diskrecionin e zyrtarit të ATK-së.

8. Rritja e numrit të vizitave të bazuara në vlerësim të rrezikut

Vizitat e bazuara në rrezik

$$= \frac{\text{Numri i vizitave te realizuara të bazuara ne vleresimin e riskut}_t}{\text{Numri total i vizitave te realizuara}_t}$$

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Departamenti për Menaxhimin e Riskut dhe Planifikimit

Periudha raportuese: Mujore

Niveli Referues: [Nuk ka nivel referues]

Caqet: [2021:80%, 2022: 85%, 2023: 90%]

Kontribuon tek: Shtylla II

Risqet e implementimit: Ndryshimi i qasjes së deritanishme lidhur me realizimin e vizitave në teren, hezitimi nga ana e drejtorive rajonale në trajtimin e rasteve nga zyra qendrore, aplikimi i ndryshimeve teknike që kërkohet të bëhen në sistem.

9. Rritja e kontrolleve bazuar në vlerësim të rrezikut

Kontrollet e bazuara në rrezik

$$= \frac{\text{Numri i kontrolleve te realizuara bazuar ne vleresimin e riskut}_t}{\text{Numri total i kontrolleve te realizuara}_t}$$

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Departamenti për Menaxhimin e Riskut dhe Planifikimit

Periudha raportuese: Mujore

Niveli Referues: [2020: 80%]

Caqet: [2021: 85%, 2022: 90%, 2023: 95%]

Kontribuon tek: Shtylla II

Risqet e implementimit: Ndryshimi i qasjes së deritanishme lidhur me realizimin e kontrollave në teren, hezitimi nga ana e drejtorive rajonale në trajtimin e rasteve nga zyra qendrore, aplikimi i ndryshimeve teknike që kërkohet të bëhen në sistem.

10. Caktimi i zyrtarëve tatimor për kontroll bazuar në vlerësim të rrezikut

$$\text{Caktimi i zyrtarëve bazuar në rrezik} = \frac{\text{Numri i zyrtarëve të caktuar për kontroll nga moduli i riskut}_t}{\text{Numri total i kontrolleve}_t}$$

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Departamenti për Menaxhimin e Riskut dhe Planifikimit

Periudha raportuese: Mujore

Niveli Referues: [Nuk ka nivel referues]

Caqet: [2021: 30%, 2022: 40%, 2023: 50%]

Kontribuon tek: Shtylla II

Risqet e implementimit: Realizimi i aktivitetit është lidhur ngushtë me zhvillimet e aspektit teknik nga ana e sistemit të TI dhe funksionalitetit të këtij sistemi, hezitimi nga ana e drejtorive rajonale në trajtimin e rasteve nga zyra qendrore.

11. Trajtimi i kërkesave specifike të tatimpaguesve bazuar në vlerësim të rrezikut

$$\text{Trajtimi i kërkesave bazuar në rrezik} = \frac{\text{Numri i kërkesave që trajtohen nga moduli i rrezikut}_t}{\text{Numri total i kërkesave}_t}$$

Ky indikator synon të masë se sa nga kërkesat specifike; regjistrimi, çregjistrimi, ndryshimi i formës/statusit së biznesit, ndryshimi i pronarit, etj., trajtohen bazuar në modulin e rrezikut. Pra, në momentin që tatimpaguesi ndryshon (për shembull) adresën, ky të mos jetë më sinjal i menjëhershëm për kontroll por të përcaktohet nga moduli i rrezikut se a është rast për kontroll apo jo.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Departamenti për Menaxhimin e Riskut dhe Planifikimit

Periudha raportuese: Mujore

Niveli Referues: [Nuk ka nivel referues]

Caqet: [2021: 80%, 2022: 85%, 2023: 90%]

Kontribuon tek: Shtylla II

Risqet e implementimit: Realizimi i aktivitetit është lidhur ngushtë me zhvillimet e aspektit teknik nga ana e sistemit të TI dhe funksionalitetit të këtij sistemi, hezitimi nga ana e drejtorive rajonale në trajtimin e rasteve nga zyra qendrore.

12. Numri i sistemeve të jashtme të ndërlidhura me sistemin e ATK-së

Ky indikator ka të bëjë me funksionin e rrezikut, kontrollit, e procedurave. Një prej mënyrave me të cilën mund ta matim performancën e këtij funksioni është numri i sistemeve të institucioneve të jashtme të cilat kanë ndërveprim me sistemin aktual të ATK-së. Kjo bëhet me qëllim që ATK-ja të ketë në dispozicion më shumë burime informatash (me noterë, banka, etj.) për qëllime analitike të funksionit të kontrollit. Aktualisht ATK-ja ka sistem të ndërlidhur informativ me: Doganën e Kosovës, Trustin Pensional, ARBK-në, ASK-në, MPMS, KGJK-në, MeF-in, Thesarin, MPB-në, NJIF [këtu të listohen të gjitha institucionet me të cilat ka ndërveprim të sistemeve të TI-së]. Niveli referues për këtë indikator është numri total i institucioneve me të cilat sistemi është i ndërlidhur; [X]. Ky numër mund të rritet përmes lidhjes së memorandumeve të mirëkuptimit (e pastaj funksionalizimit të ndërveprimit) me institucionet e ndryshme relevante, sipas agjendës që e përcakton menaxhmenti i ATK-së.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Përgjegjësia primare: Teknologjia Informative, Përgjegjësia sekondare: Departamenti për Menaxhimin e Riskut dhe Planifikimit

Periudha raportuese: Vjetore

Niveli Referues: [12]

1. Ndërlidhja me ARBK, 2020
2. Ndërlidhja me MPB/ARC dhe MPB/Regjistrimi i automjeteve, 2020
3. Ndërlidhja Komunën e Prishtinës, 2020
4. Ndërlidhja me Bankat komerciale dhe me institucionet e pagesave, 2020
5. Ndërlidhja me Tatimin ne Prone, 2020
6. Ndërlidhja me IRS (FATCA), 2019
7. Ndërlidhja me AKA, 2019
8. Ndërlidhja me ICK, 2019
9. Ndërlidhja me E-Prokurimi, 2019
10. Ndërlidhja me OJQ, 2019
11. Ndërlidhja me MZHE-SIZHEK, 2018

12. Ndërlidhja me MPMS, 2018

Caqet: [2021: 14, 2022: 17, 2023: 20]

Kontribuon tek: Shtylla II

Risqet e implementimit: Mungesa e infrastrukturës së çelësit publik (identitetit publik - IQP), rezistenca nga pala për të vendosur ndërlidhje

13. Përmirësimi i aftësive të zyrtarëve me notë të ulët

$$\text{Përmirësimi i aftësive} = \frac{\text{Numri i zyrtarëve me notë 1 – 2.5 të trajnuar}_t}{\text{Numri total i zyrtarëve}_t}$$

Qëllimi i këtij indikator është që të kthehet fokusi i zhvillimit të burimeve njerëzore tek pjesa e stafit që ka më shumë nevojë; pra ata që gjatë vlerësimeve marrin nota më të ulëta. Numri i zyrtarëve që kanë nevojë (me notë 1 deri 1.5 ‘jo i kënaqshëm/jo i mjaftueshëm’ dhe 1.5 deri 2.5 ‘kënaqshëm/mjaftueshëm’) të trajnohen.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Përgjegjësia primare: Divizioni i Burimeve Njerëzore, Përgjegjësia sekondare: Divizioni i Trajnimeve

Periudha raportuese: Vjetore

Niveli Referues: [Nuk ka nivel referues]

Caqet: [2021: 80%, 2022: 90%, 2023: 100%]

Kontribuon tek: Shtylla V

Risqet e implementimit: Mungesë e buxhetit, mungesa e programeve adekuate të trajnimeve, rezistenca e stafit për trajnim.

14. Ngritja e aftësive të zyrtarëve të ATK-së

(14. a.)

$$\text{Ngritja e aftësive të zyrtarëve} = \frac{\text{Numri i trajnimeve me testime}_t}{\text{Numri total i trajnimeve të mbajtura}_t}$$

(14. b.)

$$\text{Ngritja e aftësive të zyrtarëve} = \frac{\text{Numri i testimeve të kaluara me sukses}_t}{\text{Numri total i testimeve}_t}$$

Ky indikator synon të mat atë se sa absorbohet materiali për të cilin zyrtarët e ATK-së vijojnë trajnimet. Në planin e trajnimeve duhet bërë përpjekje që të vijohen trajnime që përmbajnë komponentë testuese/vlerësime, por në rastet kur nuk është e mundur, rekomandohet që mbikëqyrësi i zyrtarit të bëjë një vlerësim të absorbimit të materialit të trajnimit.

	2018	2019	2020
Numri total i trajnimeve	789	696	382
Numri i trajnimeve me testime ⁵	30	20	0
Numri i testimeve të kaluara me sukses	28	20	0
I4.a	3.8%	2.8%	0%
I4.b	93.3%	100%	0%

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Përgjegjësia primare: Divizioni i Burimeve Njerëzore, Përgjegjësia sekondare: Divizioni i Trajnimeve

Periudha raportuese: Vjetore

Niveli Referues (I4.a): [3.3%]

Niveli Referues (I4.b): [96.6%]

Caqet (I4.a): [2021: 4.0%, 2022: 6.0%, 2023: 10.0%]

Caqet (I4.b): [2021: 100%, 2022: 100%, 2023: 100%]

Kontribuon tek: Shtylla V

Risqet e implementimit: Mungesë e buxhetit, mungesa e programeve adekuate të trajnimeve, arsye shëndetësore të stafit për mungesë nga trajnimet, rezistenca e stafit për trajnim.

15. Publikimi i të dhënave të hapura

Publikimi i të dhënave të hapura

$$= \frac{\text{Numri total i të dataseve të hapura}_t}{\text{Numri i dataseve të ATK të identifikuar për hapje}_t}$$

Ky indikator synon të mat drejtpërsëdrejti realizimin e njërit aktivitet të objektivit/ shtyllës III të Planit për Përmirësimin e Integritetit të ATK-së, pra atë të hapjes së të dhënave. Kjo, meqë njëri nën-aktivitet i hapjes së të dhënave mundëson identifikimin e të dhënave të mundshme për hapje, e më pastaj nën-aktivitetet në vijim do të realizojnë hapjen e të dhënave të caktuara me prioritet.

⁵ Trajnimet që përfshijnë testime janë vetëm ato nga programi trajnues bazik për inspektorët e rinjë. ATK nuk ka trajnime tjera që përfshijnë module të testimit.

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Përgjegjësia primare: Zyra për Komunikim me Media; Përgjegjësia sekondare: Departamenti për Plan dhe Raportim

Periudha raportuese: Tremujore

Niveli Referues: [Nuk ka nivel referues]

Caqet: [2021: draftimi i udhezuesit; 2022: 40% 2023: 70%]

Kontribuon tek: Shtylla III

Risqet e implementimit: Aspekti teknik i realizimit në sistem të TI, faktorë të jashtezakonshëm

16. Rritja e kapaciteteve të zyrtarëve që komunikojnë me qytetarët/tatimpaguesit

Qëllimi i këtij indikator është që të mat investimin në zhvillimin e burimeve njerëzore në drejtim të përmirësimit të komunikimit me qytetarin/tatimpaguesin, pavarësisht se mund të vlerësohet që disa zyrtar të cilët komunikojnë me qytetarin/tatimpaguesin veçse kanë kapacitete të kënaqshme për komunikim me ata. Në një kohë të mëvonshme mund të matet edhe output-i, apo rezultati i trajnimeve në praktik (pra kualiteti dhe efikasiteti i komunikimeve me qytetarët/ tatimpaguesit).

Për të matur këtë indikator, duhet të sigurohemi që një zyrtar i trajnuar për mënyrën e komunikimit, por edhe për njohuritë teknike, të mos matet/konsiderohet dy herë.

(16.a)

Rritja e kapaciteteve të zyrtarëve që komunikojnë me qytetarët/tatimpaguesit

$$= \frac{\text{Numri i zyrtarëve të trajnuar me sukses për mënyrën e komunikimit}_t}{\text{Numri total i zyrtarëve që komunikojnë me qytetarët/tatimpaguesit}_t}$$

(16.b)

Rritja e kapaciteteve të zyrtarëve që komunikojnë me qytetarët/tatimpaguesit

$$= \frac{\text{Numri i zyrtarëve të trajnuar me sukses për njohuritë teknike}_t}{\text{Numri total i zyrtarëve që komunikojnë me qytetarët/tatimpaguesit}_t}$$

	2018	2019	2020
Numri total i zyrtarëve që komunikojnë me tatimpagues	70	74	75
Numri i zyrtarëve të trajnuar me sukses për komunikim	2	74 ⁶	6

⁶ Në vitin 2019, GIZ ka organizuar trajnime për komunikim të zyrtarëve që komunikojnë me tatimpagues.

Numri i zyrtarëve të trajnuar me sukses për njohuri teknike	3	1	22
Rritja e kapaciteteve të komunikimit	2.8%	100%	8%
Rritja e kapaciteteve të njohurive teknike	4.3%	1.3%	29.3%

Departamenti përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin: Divizioni i Trajnimeve

Periudha raportuese: Vjetore

Niveli Referues (16.a): [36.9%]

Niveli Referues (16.b): [11.6%]

Caqet (16.a): [2021: 37%, 2022: 40%, 2023: 60%]

Caqet (16.b): [2021: 30%, 2022: 40%, 2023: 60%]

Kontribuon tek: Shtylla III dhe Shtylla V

Risqet e implementimit: Mungesë e buxhetit, mungesa e programeve adekuate të trajnimeve, arsye shëndetësore të stafit për mungesë nga trajnimet, rezistenca e stafit për trajnim.

Mbështetur nga:



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE